



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 28, datë 31/05/2004

**“MBI
NJË SHITESË FONDI PËR BLERJEN E ÇADRËS
PËR TEATRIN E CIRKUT”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur “Mbi një shtesë fondi për blerjen e Çadrës për Teatrin e Cirkut”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, paragrafi 3, pika II/a, si dhe vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10.03.2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shtesën e limitit për investime për vitin 2004, në shumën 3.200.000 (tre milion e dyqind mijë) lekë, duke pakësuar fondin rezervë të të ardhurave të Bashkisë.
2. Ky fond investimesh t'i shtohet buxhetit të Teatrit të Cirkut për vitin 2004, për blerjen e Çadrës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Teatri i Cirkut Tiranë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI